

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

### **PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Ne baze te ligjit te Agjencise te Trajtitimit te Kredive dhe rregullores se saj

#### **Kërkesat e veçanta për perzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar ;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- të ketë kryer studimet e larta Bachelor/Master
- të ketë pervoje pune me shume se 1 vit ne administraten publike ose në sektorin privat / ose në shërbimin përmbarrimor
- të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- zoterimi i nje gjuhe te huaj perben avantazh
- të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup.

#### **Përgjegjësitë**

*Detyrat e Përgjegjësit:*

- Përgjegjesi i Sektorit të Shërbimeve Mbeshtetese varet nga Z/V Drejtori i Pergjithshem i ATK-se , merre detyra dhe pergjegjesi perpara tij per veprimtarinë e sektorit si dhe kryen cdo detyre tjeter brenda fushes se tij te pergjegjesive.
- Ndjek zbatimin e detyrave /programeve të punës të dhëna/hartuara nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm, në kohë dhe në cilësi. Raporton me shkrim tek Zv/Drejtori i Përgjithshëm në lidhje me realizmin ose jo të detyrave/programit të punës duke dhënë shpjegimet përkatëse si dhe duke nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse në rast mosrealizimi.
- Cakton detyrat e përgjithshme dhe detyra të veçanta për cdo punonjës të sektorit, ndjek dhe raporton zbatimin e tyre dhe përgjigjet për veprimtarinë e punonjësve.
- Të dijë të menaxhojë prokurimet, hedhjen e tyre në sistem.
- Ndjek dhe përditëson në bashkëpunim me specialistin e IT, evidencën operative të fazës së trajtimit ligjor të debitorëve.
- Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse është njëkohësisht Kryetar i Komisionit të Blerjeve të vogla .

- Konfirmon dhe mbikqyr lëvizjet e shoferit, kontrollon flete-udhëtimet dhe lëvizjet në rrethe në raport me parashikimet në aktet nënligjore.
- Ndjek zbatimin e urdhërave të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm.

### **Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit :**

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim
- Curriculum vitae
- Libreza e punes
- Deshmi Penaliteti

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

**Agjensia e Trajtimit të Kredive**

**Njësia Administrative nr.5, Tiranë Rruga “Dora D’Istria”, Ndërtesa 22 Hyrja 1. Kodi 3771821017**

### **Afati**

Aplikimet pranohen deri në datë 29 Mars 2022 ora 12:00. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.